

AKTI THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Dental Production” SH.P.K

ME SELI NË DURRËS

Sot, më date 18 Janar 2024, në Durrës,Ortakët:

Z.Aurelio Marulli , Shtetas Italian, i lindur më date 06.08.1980 në Napoli (NA), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identiteti CA73018EI,

Z.Giuseppe Esposito, Shtetas Italian, i lindur më date 04.07.1962 në Napoli (NA), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identiteti CA55159HI,

Z.Giovanni Curato , Shtetas Italian, i lindur më date 01.12.1976 në Napoli (NA), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identiteti CA29303LZ,

Z.Massimo Corigliano , Shtetas Italian, i lindur më date 28.06.1960 në Roma (RM), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identiteti CA25307KZ

Z. Giovanni Cefola, Shtetas Italian, i lindur më date 31.05.1961 në Barletta (BA), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identiteti CA86173IJ,

Z.Illir Hoxhallari, shtetas shqiptar, i lindur me 24.09.1970, në Durres, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identiteti H00924047I,

vendosën të krijojnë shoqërinë “Dental Production” Sh.p.k, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat si më poshtë:

NENI 1.

Shoqëria Tregtare “Dental Production” sh.p.k përbëhet në formën e Shoqërisë tregtare sipas ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” (në vazhdim Shoqëria).

Kompania është Person Juridik Privat Shqiptar. Zyra e kompanisë ndodhet në qytetin e Durrësit .Ortakët vendosin per transferimin e selise ne nje vend tjetër si dhe per shtimin e nje adrese sekondare ne Shqiperi ose jashte saj.

NENI 2.

Emri i Shoqërisë

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj me emrin tregtar “Dental Production” sh.p.k

NENI 3.

Objekti i veprimtarisë ekonomike

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me dispozitat e ligjit - këto aktivitete:

1.Laborator dentar



2. Tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te materialeve , medikamenteve dhe pajisjeve dentare.

3.Import-eksport me pakice dhe shumice te materialeve dentare per klinika dentare ,estetike dhe laboratore dentare.

4.Tregëtim te paisjeve mjeksore dentare të personalizuar për prdorim të aktiviteteve dentare

NENI 4.

Selia e kompanisë

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

Lagja Nr.4 , Rruga "Skenderbej",Pallati 6 katesh mbi Oshee , Durrës.

NENI 5.

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i ortakeve të tij në vlerën 10,000 (leke) dhe ndahet në 6 (gjashtë)kuota.

Themeluesit marrin ne pronesi kuotat e tyre ne kapitalin themeltar, në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin fillestar ndahet si më poshtë:

Z.Aurelio Marulli, 1 kuotë,me vlerën 1667 Lekë, zotëron 16.67% (gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) përqind.

Z.Giuseppe Esposito ,1 kuotë,me vlerën 1666 Lekë, zotëron 16.66% (gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë)përqind.

Z.Giovanni Curato , 1 kuotë,me vlerën 1667 Lekë, zotëron 16.67% (gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë)përqind.

Z.Massimo Corigliano , 1 kuotë,me vlerën 1000 Lekë, zotëron 10% (dhjetë) përqind.

Z.Giovanni Cefola, 1 kuotë,me vlerën 1000 Lekë, zotëron 10% (dhjetë) përqind.


Z.Illir Hoxhallari, 1 kuotë,me vlerën 3000 Lekë, zotëron 30% (tridhjetë)përqind.

NENI 6.

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kompania ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

NENI 7.



Organet drejtuese

Referuar ligjit n. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë krijohen si më poshtë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori.

Forma dhe rregullat e organizimit të Shoqërisë janë të parashikuara në statutin e Shoqërisë.

Shoqëria fillimisht administrohet nga një Administrator i vetëm i cili do të qëndrojë në detyrë për 5 vjet, i rinovueshëm, përveç rasteve kur revokohet ose jep dorëheqjen, ose për arsye të tjera ligjore.

Administrator i Shoqërisë i cili pranon, do të jetë **Z.Illir Hoxhallari**, shtetas shqiptar, i lindur me 24.09.1970, në Durres, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identiteti H009240471.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, publik ose privat, gjithashtu në marrëdhënie juridike me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto kompetenca në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm, edhe jo ortak, ose nga disa administatore edhe jo ortakë, sipas asaj që është përcaktuar në momentin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë u është besuar disa personave, vendimi i emërimit përcakton në mënyrë alternative:

- a) nëse administratorët do të funksionojnë në mënyrë kolegjiale, duke formuar kështu këshillin e administrimit;
- b) nëse administrimi i është caktuar veçmas apo bashkërisht.

NENI 8.

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë, hapja e zyrave apo degëve dytësore do të bëhet në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar dhe të Statutit.

NENI 9.

Punonjësit dhe të ngarkuarit me drejtimit e Shoqërisë janë përgjegjës dhe duhet të kompensojnë kompaninë për dëmet e shkaktuara me dashje për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10.



Ligji në fuqi

Veprimtaria e shoqërisë do të drejtohet nga rregullat e statutit të nënshkruar nga anëtarët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11.

Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me themelimin e shoqërisë do të zgjidhet nga ortakët, në të kundërt mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Durrës.

NENI 12.

Dispozitat përfundimtare

Akti i themelimit pasi u lexua nga anëtarët përbërës, u konstatua në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe nënshkruhet pa asnjë vërejtje.

ORTAKET THEMELUES

Z. Aurelio Marulli

Z. Giuseppe Esposito

Z. Giovanni Curato

Z. Massimo Corigliano

Z. Giovanni Cefola

Z. Ilir Hoxhallari